



ALBANIAN
CHAMBER OF ADVOCACY



UNIVERSITETI LUARASI FAKULTETI I DREJTËSISË

KONFERENCA SHKENCORE NDËRKOMBËTARE

“DREJTËSIA, SIGURIA DHE TË DREJTAT E NJERIUT” (KSHNDSN -FDUL 2025)



Universitat
Abat Oliba CEU



TOKAT
GAZIOSMANPAŞA
ÜNİVERSİTESİ



FAKULTET ZA
POSLOVNU EKONOMIJU
I PRAVO BAR



FUTURA


FAKULTET ZA PRIMENJENU EKOLOGIJU

EDUKA

FAKULTET ORGANIZACIONIH STUDIJA

Data e Konferencës: 8 Maj 2025
Vendi: Universiteti Luarasi & Online
Gjuha e Konferencës: Shqip / Anglisht
Organizatori: Universiteti Luarasi
Në bashkëpunim me:

- Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës
- Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës
- Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”
- Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë
- Akademia e Sigurisë
- Shkolla e Avokatisë, Dhoma e Avokatisë e Shqipërisë
- Kolegji UBT
- Kolegji AAB
- Fakultet za Poslovnu Ekonomiju i Pravo Bar
- Univerzitet Crne Gore
- Univerzitet Sinergija Bijeljina
- Fakultet za primenjenu ekologiju "Futura", Univerzitet Metropolitan Beograd
- Fakultet organizacionih studija „EDUKA“ u Beogradu, Univerzitet Privredna Akademija
- Università degli Studi di Bari Aldo Moro
- Universitat Abat Oliba CEU
- Tokat Gaziosmanpaşa Üniversitesi



Të nderuar akademikë, studiues, kërkues shkencorë dhe profesionistë të fushës së drejtësisë, sigurisë dhe të drejtave të njeriut,

Universiteti Luarasi ka kënaqësinë t’ju ftojë të merrni pjesë në **Konferencën Shkencore Ndërkombëtare** me temën **“DREJTËSIA, SIGURIA DHE TË DREJTAT E NJERIUT” (KSHNDSDN -FDUL 2025)**, e cila do të zhvillohet më **8 maj 2025**.

Kjo konferencë ka për qëllim të sjellë së bashku akademikë, ekspertë dhe profesionistë të së drejtës, sigurisë dhe të drejtave të njeriut për të shkëmbyer perspektiva shkencore dhe praktike mbi çështje të rëndësishme ligjore dhe të sigurisë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Në kuadër të temës së përgjithshme të konferencës, sesionet do të organizohen në tre panele kryesore, duke synuar të ofrojnë një hapësirë gjithëpërfshirëse për diskutime dhe analiza nga perspektiva të ndryshme akademike dhe profesionale. Panelet do të mbulojnë tematika të ndryshme brenda fushës së **të drejtës, sigurisë dhe të drejtave të njeriut**, duke i lënë hapësirë autorëve për të zgjedhur temat sipas interesave të tyre kërkimore.

1. Paneli i së Drejtës Civile

Ky panel do të fokusohet në zhvillimet dhe sfidat ligjore që lidhen me marrëdhëniet civile, të drejtën private dhe mbrojtjen e të drejtave të individëve dhe subjekteve juridike. Tematikat orientuese përfshijnë, por nuk kufizohen në:

- ◆ **Të drejtat dhe liritë themelore në marrëdhëniet civile dhe tregtare**
- ◆ **E drejta e pronës dhe sfidat e mbrojtjes së saj në kontekstin ndërkombëtar**
- ◆ **Mbrojtja e konsumatorit dhe sfidat e tregut global**
- ◆ **Kontratat digjitale, transaksionet elektronike dhe ndikimi i teknologjisë në të drejtën civile**
- ◆ **Arbitrazhi dhe zgjidhja alternative e mosmarrëveshjeve**
- ◆ **E drejta familjare dhe aspekte bashkëkohore të mbrojtjes së fëmijëve dhe familjes**
- ◆ **Mbrojtja e të dhënave personale dhe sfidat ligjore të privatësisë**

2. Paneli i së Drejtës Penale

Ky panel do të trajtojë sfidat bashkëkohore në fushën e së drejtës penale dhe sistemit të drejtësisë penale, pare edhe në raport me sigurinë kombëtare dhe ndërkombëtare. Tematikat orientuese përfshijnë, por nuk kufizohen në:

- ◆ **Krimi i organizuar dhe sfidat e drejtësisë penale**
- ◆ **Krimet financiare, pastrimi i parave dhe mekanizmat ligjorë për parandalimin e tyre**
- ◆ **Krimet kibernetike, siguria digjitale dhe përgjegjësia penale në botën virtuale**
- ◆ **Terrorizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm: Masat ligjore dhe efektiviteti i tyre**
- ◆ **Sfidat e reformës në drejtësinë penale dhe ndikimi në të drejtat e njeriut**
- ◆ **Drejtësia penale për të miturit**
- ◆ **Të drejtat e viktimave në procesin penal dhe qasja ndaj drejtësisë**
- ◆ **Përgjegjësia penale e korporatave dhe sfidat e ndjekjes penale të subjekteve juridike**

3. Paneli i së Drejtës Publike

Ky panel do të fokusohet në ndërveprimin midis shtetit, institucioneve dhe individëve në kontekstin e të drejtës publike, sigurisë dhe të drejtave të njeriut. Tematikat orientuese përfshijnë, por nuk kufizohen në:

- ◆ **E drejta kushtetuese dhe mbrojtja e lirive themelore**
- ◆ **Siguria kombëtare dhe balancimi i saj me të drejtat themelore të njeriut**
- ◆ **E drejta administrative dhe transparenca në vendimmarrje**
- ◆ **Të drejtat e njeriut në kohë krizash dhe emergjencash**
- ◆ **Sfidat ligjore të integritetit evropian dhe ndikimi në sistemin juridik shqiptar**
- ◆ **Liria e shprehjes dhe kufijtë e saj në epokën e informacionit**
- ◆ **E drejta ndërkombëtare publike dhe mekanizmat e mbrojtjes së të drejtave të njeriut**

Autorët janë të lirë të propozojnë punime që lidhen me temën e përgjithshme të konferencës duke u fokusuar në **çështje aktuale, raste studimore, zhvillime ligjore dhe propozime për përmirësime të kuadrit normativ** në fushat përkatëse.

Afatet dhe udhëzimet për dorëzimin e materialeve:

- Afati për dorëzimin e abstrakteve (shqip & anglisht): **24 Mars 2025**
- Njoftimi për pranimin e abstraktit: **30 Mars 2025**
- Afati për dorëzimin e punimit të plotë: **30 Prill 2025**
- Data e Konferencës: **8 Maj 2025**
- Vendi: **Universiteti Luarasi** dhe *online*
- Gjuha e Konferencës: **Shqip** dhe **Anglisht**

Komiteti Shkencor dhe Komiteti Organizativ i Konferencës, ftojnë të gjithë studiuesit, profesionistët dhe institucionet që janë të interesuar për të marrë pjesë, të na shkruajnë në adresën e e-mail-it: law.conference2025@luarasi-univ.edu.al

Komiteti Shkencor Ndërkombëtar i Konferencës

- 1) Prof. Dr. Maksim Haxhia
- 2) Prof. Dr. Dorina Hoxha
- 3) Prof. Dr. Ilirjan Mandro
- 4) Prof. Dr. Skënder Kaçupi
- 5) Prof. Dr. Jean-Christophe Gay
- 6) Prof. Dr. Snežana Štetić
- 7) Prof. Dr. Žaklina Spalević
- 8) Prof. Dr. Vladica Ristić
- 9) Prof. Dr. Marija Maksin
- 10) Prof. Dr. Violeta Babić
- 11) Prof. Asoc. Dr. Admir Belishta
- 12) Prof. Asoc. Dr. Mentor Lecaj
- 13) Prof. Asoc. Dr. Egzone Osmanaj
- 14) Prof. Asoc. Dr. Besard Belegu
- 15) Prof. Asoc. Dr. Artan Fejzullahu

Komiteti Organizativ i Konferencës

- 1) Prof. Asoc. Dr. Luan Veliqoti
 - 2) Prof. Asoc. Dr. Denard Veshi
 - 3) Dr. Lorenc Stojani
 - 4) Dr. Blerina Shkurti
 - 5) Dr. Dael Dervishi
 - 6) Dr. Katrin Treska
 - 7) Dr. Ermira Tafani
 - 8) Dr. Blendi Himçi
 - 9) PhD(c) Ganimete Ismajli
 - 10) Msc. Geron Kamberi
-

Rregullat e punimit me shkrim:

Autorët duhet të përgatisin punimin e tyre shkencor shqip dhe anglisht, duke iu përmbajtur rregullave si më poshtë vijon:

- **Titulli:** Times New Roman, 14, **Bold**
- **Autori:** Emri, titujt akademikë, institucioni dhe e-maili
- **Abstrakti:** Shqip dhe Anglisht, 250-300 fjalë, me shkrim *Italic* “Times New Roman 12”, hapësirë 1, teksti “Justified”;
- **Pjesa kryesore e punimit:** Duhet të ndahet sipas nënçështjeve përkatëse;
- **Gjatësia:** Materiali duhet të jetë 10 – 12 faqe kompjuterike në format “Word”;
- **Shkrimi i Materialit:** “Times New Roman 12” me hapësirë 1 dhe i gjithë teksti të jetë “Justified”;
- **Referencat dhe citimet:**
 - **Footnote:** Duhet të shkruhet me shkrim “Times New Roman 10” dhe të përmbajë: titullin e veprës, autorin, shtëpinë botuese, datën dhe vendin e botimit, si dhe faqen nga është marrë citati;
 - Nëse është përdorur një faqe web/site interneti, duhet të shënohet edhe data e aksesueshmërisë;
 - Në fund të footnote-s vendoset pikë dhe footnote-a jepet me “Justify”.

Mosrespektimi i rregullave sa më lart nga ana e autorëve do të sjellë përjashtimin e tyre nga konferenca dhe botimi i saj.

Punimet do të shqyrtohen nga Komiteti Shkencor dhe të pranuarat do të botohen në një volum të dedikuar për konferencën, pajisur me ISBN.

Mënyra e pjesëmarrjes:

Konferenca do të ofrojë **mundësi pjesëmarrjeje fizike** dhe **online** përmes një platforme dhe/ose paneli të dedikuar.

Regjistrimi dhe informacione të mëtejshme:

Për çdo pyetje ose regjistrim, ju lutemi na kontaktoni në adresën elektronike të konferencës:

law.conference2025@luarasi-univ.edu.al

Ju mirëpresim në këtë konferencë me rëndësi të veçantë për drejtësinë, sigurinë dhe të drejtat e njeriut!